



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 608/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet si e palejuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik LVV, me të cilën kërkohet që të përsëriten votimet në komunën e Skenderajt, Drenasit, Deçanit dhe Malishevës, për shkak të parregullsive të mëdha gjatë procesit zgjedhor. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 4 paragrafi 2 parasheh:

PZAP-i mund ti hidh poshtë (si të palejuara, të parregullta parregullta apo të pasafatshme) ankesat të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, poashtu PZAO-refuzon ankesat të cilat janë të pabazuar, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e Panelit të Zgjeruar të datës 16.12.2010, Anr. 528/2010. Pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 608/2010 më datën 16.12.2010.

